REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCAVE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

KORRIK - JULY

2005

TIRANE

Raporti Mujor

Korrik 2005

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE.....6

   a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....8
   b. SEKTORI FISKAL.....11
   c. SEKTORI I JASHTEM…….13
   d. SEKTORI MONETAR……..14

3. TABELAT MBËSHTETËSE

   a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit
   b. Kursi i këmbimit
   c. Buxheti i konsoliduar
   d. Shpenzimet institucionale
   e. Shpenzimet sipas funksionit
   f. Investimet
   g. Të ardhurat sipas burimeve
   h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik
   i. Financimi i defiçitit
   j. Mjete valutore neto
   k. Krediti i brendshëm
   l. Oferta e parasë
   m. Depozitat sipas burimeve

1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Korrik, arriti ne 105.4 perqind, duke shenuar nje renie mujore prej - 1.2 përqind, pas uljes mr – 0.5 perqind dhe - 1.1 perqind, perkatesisht ne muajt qershor dhe maj. Norma vjetore e inflacionit, per muajin Korrik, ishte 1.8 perqind duke qendruar brenda objektivit te Bankese se Shqiperise, prej 2 – 4 perqind.



- **Kursi mesatar i kembimit** per muajin Korrik 2005, ishte:

  - 101.28 leke per dollare
  - 121.99 leke per euro



Ne muajin Korrik shohim nje mbicmim te monedhes sone kombetare, kundrejt dy mondhave kryesor monedhes europiane Euros dhe dollarit amerikan. Ky eshte reflektimi i sjelles se dy monedhave ne tregjet nderkombetare monetare. Gjithashtu afrimi i sezonit te veres ndikon ne rritjet e prurjeve te emigranteve ne monedhen euro, duke cuar ne nje forcim te lekut gjate kesaj periudhe, kryesisht kundrejt monedhes europiane .

Gjate muajit maj 2005, **normat e interesit te depozitave** 12 mujore ne leke, kane pesuar nje renie ne vlere absolute prej 0.35 perqind krahasuar me nje muaj me pare, duke vazhduar ne kete menyre trendin e tyre renes gjate kesaj periudhe te vitit 2005. Kjo ecuri ka ardhur si nje pergjigje ndaj politikave te ndermarra nga Banka e Shqiperise, ku mund te permendim ate te uljes se normes baze te interesit. Nje faktor tjeter qe ka ndikuar ne uljen e normave te interesit te depozitave ne leke ka qene edhe teprica ne likuditete ne ekonomine shqiptare. Renien me te ndjeshme gjate kesaj periudhe e kane patur normat e interesit te depozitave 12-mujore dhe 6-mujore, me rreth 1.89 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar.



	Maj '04	Qer '04	Korr '04	Gusht '04	Shtat '04	Tet '04	Nent '04	Dhje '04	Jan '05	Shku '05	Mars '05	Prill '05	Maj '05
12-M	6.76	6.96	6.39	6.27	6.26	6.13	6.13	5.99	5.81	5.72	5.44	5.22	4.87
6-M	6.30	6.10	6.01	5.85	5.79	5.63	5.58	5.41	5.36	5.18	4.85	4.70	4.41
3-M	5.06	4.89	4.88	4.89	4.83	4.76	4.69	4.48	4.49	4.36	4.16	3.95	3.47

Renien me te ndjeshme gjate kesaj periudhe e kane patur normat e interesit te depozitave 6 dhe 12-mujore, me rreth 1.89 perqind, krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar.

Krahasuar me muajin prill 2005, renie ka patur edhe per depozitat me afat gjashtemujor me 0.29, te normave me afat tremujor me 0.30 perqind dhe te normave me afat njemujor, me 0.09 perqind.

❖ Situata buxhetore

Ne fund te muajit Korrik 2005, situata buxhetore, paraqitet si vijon:

1. **Deficiti i pergjithshem** buxhetor arriti ne rreth 14.2 miliarde leke, ose rreth 33.7 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2005.
2. **Te ardhurat gjithsej** arriten ne rreth 109 miliarde leke ose rreth 52.8 perqind e programit vjetor 2005.
3. **Shpenzimet buxhetore** arriten ne rreth 123.2 miliarde leke, ose rreth 49.6 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2005.



- **Deficiti i pergjithshem** arriti ne 14,214 milion leke nga 14,523 milione leke te parashikuar per kete periudhe 7-mujore, duke perballuar ne kete menyre kryerjen e shpenzimeve ne kohen e duhur.

- **Të ardhurat gjithsej** arritën në rreth 52.8 përqind të parashikimit vjetor. Ato përfshijnë:

  - Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 53.52 përqind të programimit vjetor;
  - Kontributet për sigurimet shoqërore prej 55.38 përqind;
  - Të ardhurat jo-tatimore 47.09 përqind e buxhetit vjetor; dhe
  - Të ardhurat nga pushteti lokal, 67.17 përqind e planifikimit vjetor

Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 49.6 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 107,260 milione lekë ose rreth 55.6 përqind e programimit vjetor, pjesërisht si rezultat i shpenzimeve të larta në pagesat e interesit me rreth 53.4 perqind te buxhetit vjetor, te shpenzimeve per sigurimet sociale me rreth 56 përqind e buxhetit vjetor dhe i shpenzimeve të larta operative dhe te mirembajtjes me rreth 61.7 perqind e buxhetit vjetor.

- **Bilanci i pagesave**

Bilanci i pagesave per muajin Mars 2005, rezultoi me nje sufiçit te pergjithshem prej 5.6 milion dollare. Kjo ishte rezultat i nje:

  - defiçiti te Llogarise Korente, prej rreth 1.8 milion dollare;
  - suficiti te Llogarise se Kapitalit, prej rreth 16.6 milion dollare;
  - sufiçiti te Llogarise Financiare, prej rreth 35.3 milion dollare;
  - bilanci negativ ne "Gabime dhe Harresa neto" prej rreth 44.5 milion dollare.



Komponentet kyc te defiçitit te **Llogarise Korente** prej 1.8 milion $ ishin nje:

- bilanc tregtar negativ prej 130.8 milion dollare;
- sufiçit prej 2 milion dollare ne bilancin e sherbimeve;
- suficit prej 15.4 milion dollare ne bilancin e te ardhurave;
- suficit prej 111.6 milion dollare ne transfertat/ te ardhurat nga emigrantet.



Në baze kumulative, në fund te 3-mujorit 2005, bilanci i pagesave rezultoi me sufiçit të përgjithshëm, prej 12.7 milionë dollare.

Komponentët kyç ishin:

- defiçiti prej 56.3 milionë dollare, në llogarinë korrente,
- sufiçiti prej 46.6 milionë dollare ne llogarine kapitale,
- suficiti prej 19.5 milionë dollare në llogarinë financiare,
- bilanc pozitiv i gabimeve dhe harresave neto prej 2.8 milionë dollare.

- **Oferta totale e parasë,** e matur nga M3 arriti në 533.2 miliardë lekë në fund të muajit maj, duke shenuar një rritje me rreth 16 perqind ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te kaluar, nga 13 perqind qe ishte ne fund te muajit dhjetor.



Ndikimin kryesor ne rritjen e ofertes monetare gjate muajit maj e kane patur rritja e depozitave ne valute te huaj, te cilat vetem gjate ketij muaji u rriten me rreth 4.6 miliard leke. Kjo ecuri e depozitave ne valute ka pasqyruar kryesisht nençmimin e kursit të këmbimit te lekut gjate periudhes janar – maj.

Rritmi i rritjes se ofertes monetare ka shenuar rritje, duke u pershtatur me ecurine pozitive të aktivitetit ekonomik ne periudhen aktuale dhe me rritjen e volumit te parasë së mbajtur nga agjentet ekonomike per financimin e transaksioneve të tyre. Gjithashtu, rritja e ofertes monetare gjate kësaj periudhe, ka reflektuar edhe zhvillimet pozitive në drejtim të thellimit të ndermjetësimit financiar ne vend dhe konsolidimit të besimit ne sistemin bankar. Kontributi i kredise per ekonomine ne gjenerimin e mjeteve monetare ne leke ka ardhur në rritje, nderkohe qe kerkesa per para e qeverise ka qene pothuajse ne te njejtat nivele te nje viti me pare.

Rritja e ofertes monetare rritje erdhi si pasoje e rritjes se depozitave pa afat ne leke me rreth 89 perqind, depozitave ne valute me rreth 23 perqind, depozitave me afat ne leke me rreth 7 perqind dhe rritjen te parase jashte sistemit me rreth 12 perqind, krahasuar me nje vit me pare.



2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

a. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit per muajin Korrik pati nje ulje prej – 1.2 perqind, krahasuar uljet gjate muajve Qershor 05 dhe Maj 05 perkatesisht me – 0.5 dhe – 1.1 perqind. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj te nje viti me pare ishin – 0.2 perqind, - 1.4 perqind dhe – 1.7 perqind.

Kjo ulje prej – 1.2 perqind e indeksit te çmimeve te konsumit per muajin Korrik erdhi si pasoje e uljes se indeksit te grupit "Ushqime dhe pije jo alkolike" me – 3.5 perqind , e cila erdhi si pasoje e uljes se cmimeve te nengrupeve "zarzavate perfshire patatet" me – 15.8 perqind dhe te nengrupit "Fruta"dhe "Ushqime" respektivisht me –13.1 dhe – 3.7 perqind.

Ulje ne kete muaj pesoi edhe grupi "Veshje dhe kepuce" me - 0.5 perqind.

Gjate muajit korrik, grupi "Transporti" shenoi nje rritje perj 0.9 perqind, e cila erdhi si pasoje e rritjes se cmimit te karburanteve me 4.4 perqind.

Rritje per kete muaj shenoi edhe grupi "Qera, uje lende djegese dhe energji" prej 0.7 perqind, ku mund te permendim rritjen e cmimit te qerave te banesave prej 0.9 perqind.

Norma vjetore e inflacionit ne muajin Korrik arriti ne 1.8 perqind duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2004 dhe 2005 paraqiten ne tabelen e meposhtme :

	Jan	**Shku**	**Mars**	**Prill**	**Maj**	**Qer**	**Korr**	**Gusht**	**Shta**	**Tet**	**Nen**	**Dhj.**
2005	3.3	1.8	1.6	1.3	2.0	2.9	1.8					
2004	3.3	4.4	4.0	3.2	2.6	2.9	3.1	2.7	2.0	2.0	2.2	2.2

Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i kembimit te lekut me dollarin amerikan, gjate muajit Korrik, pesoi uje prej – 0.36 perqind kundrejt muajit Qershor 2005. Ne fund te muajit Korrik ky kurs arriti vleren prej 100.45 leke/ dollare. Kursi mesatar I kembimit per Dollarin ne muajin Korrik arriti ne 101.28 leke/dollare.

Kursi mesatar i kembimit per Euron ne muajin Korrik arriti ne 121.99 Leke/Euro duke shenuar nje rrenije te konsiderueshme prej – 1.33 perqind krahasuar me nje muaj me pare, ndersa ne fund te muajit Korrik Euro u kembye me 121.31 leke, I cili eshte dhe niveli me I ulet I kuotimit te Euros qe prej daljes se saj ne Janar 2002.

Gjate ketij muaji shohim nje mbicmim te lekut kundrejt dy monedhave kryesore, Euros dhe Dollarit amerikan.

Ne krahasim me muajin Korrik te vitit te kaluar rezulton se monedha shqiptare eshte vlersuar ndaj monedhes europiane me 1.8 perqind dhe ka qendruar ne pothuajse ne te njejtat nivele si nje vit me pare kundrejt dollarit amerikan.



Ndikiminin me te madh ne ecurine e kursit te kembimit te dollarit amerikan e ka luajtur faktori i jashtem, gje qe ka reflektuar ecurine e tyre edhe ne tregun tone valutor. Kursi i kembimit te euros me dollarin amerikan pesoi nje ulje mesatare duke arritur ne rreth 1.19 dollare/euro.

Interesi i huave 12-mujore ne muajin maj u ul me rreth 3.05 perqind, duke arritur ne 10.64 perqind nga 13.69 perqind qe ishte nje muaj me pare. Ndersa norma per interesin e huave 6-mujore pesoi nje rritje me 1.1 perqind, krahasuar me muajin prill. Interesi i huave 6-mujore per muajin maj arriti 14.6 perqind



Normat e interesit te Bonove te Thesarit per muajin maj, per bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin 6.8 perqind, 6.44 perqind dhe 5.04 perqind.
Nje faktor tjeter qe ka ndikuar ne uljen e normave te interesit te letrave me vlere ka qene, pervec uljes se interesave ne fund te muajit mars nga ana e Bankes se Shqiperise edhe konkurrenca nderbankare ne kete treg..

b. Sektori Fiskal

Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Korrik, jane mbledhur rreth 109,019 milione leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 123,234 milione leke, qe perfshijne 107,260 milione leke ne shpenzime korente dhe 15,973 milione leke shpenzime kapitale.

Si rrjedhim, deficiti ishte ne nivelin e 14.2 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben rreth 52.79% te te ardhurave buxhetore per vitin 2005, ndersa shpenzimet perbejne 49.56% te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane rreth 45.62 % e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane rreth 31.62 % e ketij planifikimi.
Nga te ardhurat gjithsej, pjesa e te ardhurave te mbledhura nga Drejtoria e Pergjithshme te Tatimeve dhe Doganave eshte rreth 72,369 milione leke (ose rreth 53.52 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 6,955 milione leke (67.17 % e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 20,304 milione leke (55.38 % e te ardhurave vjetore te

planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 8,174milione leke (47.09 % e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 107,260 milione leke, 29,593 milone leke (28 %) eshte shpenzuar per personelin, 15,940 milione leke (15 %) per interesat, 13,540 milione leke (13 %) per shpenzime operative dhe mirembajtje, 1,937 milione leke (2 %) per subvencione, 30,886 milione leke (29 %) per shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore dhe 15,365 milione leke (14 %) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 53.58 % (shpenzime personeli), 53.37 % (shpenzime per interesat), 61.68 % (shpenzime operative dhe te mirembajtjes), 70.82 % (subvencione), 55.98 % (sigurimet sociale), 54.31 % dhe 56.36 % (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 15,973 milione leke, nga te cilat 65 % financim i brendshem, dhe 35 % financim i huaj.

Shpenzimet kapitale me financim te brendshem, llogariten per kete periudhe ne rreth 37.21 % te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte vetem 24.7 %.

Deficiti prej 14,214 milione leke eshte i barabarte me 33.72 % te deficitit buxhetor per 2005.

Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej arriten në fund të muajit Korrik 2005 ne rreth 109,019 milione lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 99,628 milione, grantet 1,218 milione dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 8,348 milione;

Nga totali i të ardhurave tatimore, rreth 72,369 milione lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 6,955 milione lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 20,304 milione leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Mars kishin kete perberje:

- TVSH 33,592 milionë lekë
- Tatimi mbi fitimin 10,720 milionë lekë
- Taksa doganore 7,000 milionë lekë
- Taksat nacionale 5,486 milionë lekë

- Akcizat 9,336 milionë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 2,616 milione lekë;

Financimi i deficitit

Deficiti prej 14.2 miliardë lekë, ne fund te muajit korrik, u financua ne masen 82 përqind me financim të brendshëm dhe 18 përqind me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishin mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa per financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

c. Sektori i Jashtëm

Bilanci i Pagesave

Tiparet kryesore të bilancit të pagesave për periudhen Janar - Mars 2005 ishin:

Nje sufiçit i pergjithshem, prej 12.7 milion dollare, rezultat ky i nje:

- defiçiti te Llogarise Korente, prej 56.3 milion dollare ;
- suficit te Llogarise Kapitale, prej 46.6 milion dollare ;
-

d. Sektori Monetar

Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate muajit Prill 2005, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, ne rreth 263.5 milione dollare krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare, duke rezultuar ne ritme rritjeje me te ulta ne krahasim me periudhat e kaluara.



Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 92.8 milione usd, nderkohe qe mjetet valutore neto te Bankes se Shqiperise, jane rritur me 170.7 milione dollare.

Në muajin maj sistemi bankar rezulton me një ulje prej 56.3 milionë dollarësh në mjetet valutore neto, krahasuar me një muaj më parë. Rezerva valutore neto e Bankës së Shqipërisë ka njohur renie me 34.1 milionë usd. Kjo eshte e lidhur ne rradhe te pare me uljen e flukseve hyrese dhe dalese te valutes nga burime te tjera, si dhe me nencmimin e euros ndaj dollarit, duke ndikuar direkt ne uljen e vleres se portofolit ne euro te rezerves volutore, dhe mjeteve valutore neto te BSH.

Gjithashtu ulje kane pesuar edhe mjetet valutore neto të bankave tregtare, me 22.2 milionë usd. Rritja e kreditimit në valutë gjatë kesaj periudhe, nuk ka mundur të financohet tërësisht nga rritja e depozitave në valutë në bankat tregtare, duke bërë të nevojshëm përdorimin e një pjese të mjeteve valutore të tyre.

Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine ne fund te muajit maj 2005 arriti ne 88.7 miliarde leke. Rritja e teprices së kredise krahasuar me nje vit me pare shenoi vleren 32.5 miliardë leke, me nje rritje prej rreth 58 për qind. Krahasuar me nje muaj me pare kjo rritje ishte 4.8 miliarde leke.

Nga struktura e teprices se kredise sipas afateve verehet nje rritje e peshes se kredive afatgjata, te cilat arritin ne 33.2 perqind, nga 23 perqind qe ishte nje vit me pare. Teprica e kredise sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valute, duke perbere 79 perqind te totalit te treprices se kredise. Gjate kesaj periudhe vihet re një angazhim në rritje i bankave drejt kredisë me afat maturimi mbi 1 vit, duke ulur ndjeshëm financimin e ekonomisë me kredi afatshkurtër.

Hyrja e bankes "Raiffeissen" ne tregun e kredidhenies, i ka nxitur bankat te tregohen me aktive ne tregun e kredise duke shfrytezuar mundesi te reja. Nje rol te rendesishem ne rritjen e vellimit te kredise afatgjate mendohet qe te kete luajtur edhe forcimi i marredhenieve midis bankave dhe klienteve te tyre, bizneseve dhe individeve. Ketyre te fundit po i kushtohet me shume vemendje nga bankat, sikurse konstatohet edhe nga rritja e vazhdueshme e portofolit te kredise per individet.

Forcimi i marrëdhënieve bankë – klientë, po rrit besimin e bankave për të investuar më shumë në aktivitetin kreditues duke rritur rolin e tyre si ndërmjetës financiarë.

Pesermujori i vitit 2005, ka forcuar me tej tendencen renese te kredise per sektorin e tregtise, si dhe nje mbeshtetje me te madhe me kredi per sektoret prodhues dhe per blerjen e pasurive te paluajtshme. Nje zhvendosje e tille pasqyron tendencen e bankave per te ofruar produkte te reja, ne pershtatje me kerkesat e bizneseve dhe te individeve. Megjithate kredia e re akorduar per sektorin e tregtise vazhdon te mbetet mbizoteruese me rreth 24 perqind, me pas vijne sektori prodhues me 21 perqind, pasurite e paluajtshme me 12 perind, ndertimi me 8 perqind etj.

Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), per muajin maj ka shenur nje rritje prej 1.37 perqind karahasuar me muajin prill '05. Kjo oferte kapi shifren rreth 533.2 miliardë lekë në fund të muajit maj. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 16 perqind, duke shenuar nje rritje prej 5.1 pikesh perqindjeje kundrejt nivelit te rregjistruar ne muajin dhjetor. Pershpejtimi i ritmit te rritjes se ofertes monetare i dedikohet rritjes me te larte te depozitave ne valute.

Niveli i parase jashte bankave eshte ulur me 7.4 miliarde leke ne krahasim me muajin dhjetor 2004. Rritja vjetore e ketij treguesi ishte 11.5 perqind.

Raporte te parase jashte bankave



	Maj 04	Qer 04	Korr 04	Gusht 04	Shtat 04	Tet 04	Nent 04	Dhje 04	Jan ,05	Shku 05	Mars 05	Prill 05	Maj 05
PJB/M3	25.5	25.8	26.4	26.6	25.9	25.9	26.0	27.2	25.8	25.4	24.8	24.8	24.5
PJB/Dep	34.1	34.8	35.9	37.3	35.4	35.0	35.2	37.4	34.8	34.0	33.0	33.0	32.5

Raporti i parase jashte bankave ndaj ofertes monetare, ne fund te muajit maj arriti ne 24.5 perqind duke shenuar nje ulje prej 0.3 perqind ne krahasim me muaj me pare dhe, duke shenuar nivelin me te ulet historik ne 12 vitet e fundit. Ky treguesi ka qene përbërësi me rritjen më të ngadaltë në ofertën monetare.

Ulja e ketij treguesi eshte reflektim kryesisht i zhvillimeve pozitive në infrastrukturën e pagesave, të cilat janë shoqëruar me rritjen e përdorimit të shërbimeve bankare nga ana e publikut duke ndikuar ne forcimin e stabilitetit financiar te arritur Gjithashtu, ruajtja e normave reale të interesit në nivele të qëndrueshme pozitive ka mbështetur investimet në instrumentet financiare në lekë, duke shërbyer si premisë për mbajtjen në ekuilibër të strukturës së likuiditetit të ofertës monetare

Raporti i parase jashte bankave me depozitat ne muajin maj arriten shifren prej 32.5 perqind duke pesurar nje rrenie prej 0.5 perqind krahasuar me nje muaj me pare.

Depozitat ne leke si perberesi kryesor i ofertes monetare, kane pesuar nje rritje prej 0.9 perqind krahasuar me nje muaj me pare. Ecuria e kenaqshme e tyre eshte rezultat i rritjes se kerkeses për mjete monetare ne leke dhe rritjes se besimit ne monedhen vendase.

Depozitat në valutë, ne fund te muajit maj 2005 kane shenuar nje rritje te larte prej 3.6 perqind ne krahasim me muajin prill. Norma vjetore e rritjes se tyre ne fund te muajit prill arriti ne 23 perqind nga 10 perqind qe ishte ne fund te muajit dhjetor.

Depozitat sipas Burimeve

Kjo tabelë tregon përbërjen e depozitave te cilat kontribuojnë në përkufizimet e ndryshme të ofertës së parasë (Tabela 15) sipas llojit të depozituesve.
Një shqyrtim i tabelës tregon se gjate muajit maj 2005:

- Sektori i individeve zuri nivelin me te larte te depozitave pa afat ne leke me 42 perqind, ndjekur nga sektori privat me 33 perqind dhe nga ndermarjet jofinanciare publike me 20 perqind.
- Individet si edhe sektori privat ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave pa afat në monedhe të huaj, perkatesisht me rreth 46.7 perqind dhe 41.3 perqind.
- Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.6 përqind e totalit) dhe depozitave me afat në monedhe të huaj (me 90.1 përqind e totalit te depozitave;
- Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 83.7 përqind) të depozitave totale prej 402 miliardë lekësh ne muajin maj 2005. Ata ndiqen nga sektori privat (11.6 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (3.4 përqind) dhe autoritetet lokale (0.7 përqind). Institucionet financiare kontribuan me 0.5 për qind ne totalin e depozitave.



- Gjatë muajit maj 2005, krahasuar me nje muaj me pare, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 7.1 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave pa afat në lekë (0.45 miliardë lekë), depozitave me afat ne leke (2.06 miliard leke), depozitave me afat ne monedhe te huaj (4.14 miliard leke), dhe depozitave pa afat ne valute (0.43 miliarde leke).

- Depozitat pa afat dhe me afat ne leke te familjareve pesuan nje rritje prej rreth 1.2 miliarde dhe 1.29 miliarde leke gjate muajit maj.